

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ROOFINVESTIMENT Sh.p.k

Sot 24 Dhjetor 2024, në Tiranë, si ortak i vetëm themelues me të dhënat e mëposhtme:

Zj. Elisa Kumrija e lindur në Krujë, më 21/04/2000, banues në Rr. Sulejman Delvina, Nd. 37/1, Ap. 6, Njesia Bashkiake nr. 5, Tiranë dhe me dokument identifikues nr. K05421044N.

Vendosi të nënshkruajë Aktin e Themelimit mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Biznesi i shoqërisë do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i Shoqërisë i cili është përbërëse e këtij akti, të cilit i bashkëlidhet (më poshtë Shtojca 1).

Art. 1- Emri

1.1 Emri i Shoqërisë është ROOFINVESTIMENT Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

2.1 Zyra e regjistruar e Kompanisë është e vendosur në Rr. Sulejman Delvina, Nd. 37/1, Ap. 6, Njesia Bashkiake nr. 5, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

3.2 Shoqëria mund të shpërbëhet herët ose të zgjatet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 – Objekti i aktivitetit të shoqërisë

Shoqëria ka për objekt aktivitetet e mëposhtme:

Krijimi i institucioneve financiare, prodhimi i produkteve tekstile, pergatitja e dietave per institucionet shteterore si spitalet dhe ushtria, prodhimi i produkteve farmaceutike. Agjensi rekrutimi per emigrantet, ndertimi i rezidencave publike, shteterore dhe private, perfshire spitale dhe bunare.

Import-eksport dhe tregti me shumice e naftes, gazit, GNL dhe nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante, transporti kombetar dhe nderkombetar i tyre. Import-eksport dhe tregti me shumice te teknologjise dhe telefonise dhe pjeseve te kembimit per ushtrimin e veprimtarise hidrokarbure, te automjeteve te transportit te hidrokarbureve.

Rrjeti 5G, transmetimi i programeve televizive, radiofonike, zhvillimi dhe mirembajtja e pajisjeve mekatronike. Operimi i qendrave te thirrjeve (call center) dhe kazinove, zbulimi dhe mirembajtja e artefakteve historike. Suport teknik online nderkombetar ne fushen e teknologjise, organizimi i ankandeve dhe riciklimi i produkteve plastike, gomave, metaleve dhe nenprodukteve te tyre.

Ndertimi dhe venia ne perdorim e depove hidrokarbure, rezervuareve, te linjave dhe pikave te shitjes se tyre sipas projektit teknologjik. Licensa per blerjen-shitjen e energjise dhe licensa per blerjen e telefonise me shumice brenda dhe jashte vendit. Ndertimi i depo stacionare per karburante dhe nenproduktet e tyre.

Trajtimi dhe riciklimi i mbetjeve ajrore, toksore, detare dhe nenprodukteve te tyre. Germimi dhe shfrytëzimi i lëndve minerale ose materialeve të rena nga qielli (meteor, krom, flori etj.). Prodhimi dhe shfrytëzimi i fermave fotovoltaike dhe turbinave të cres per energji.

Agjensi turistike, doganore dhe spedicionere, te transportit tokesor, detar dhe ajror civil, te pasagjereve dhe mallrave. Shit-blerja e mjeteve te lundrimit, furnizimi i mjeteve lundruese me materiale, furnizime ushqimore dhe uje. Organizim i guidave turistike dhe promocion i linjave te kroqierave ne portet e Shqiperise.

Agjensi sigurie, mbrojtja e peizazheve natyrore, pastrimi i lumejve dhe pyjeve, zhvillimi i turizmit dhe kullinarise, duke perfshire parcelat me fruta, perime dhe ushqimet e kategorise A. Investime ne pasuri te paluajtshme (Real Estate), sherbime avokatie dhe konsulence ligjore, pastrim kimik dhe mirembajtje te rezidencave publike, shteterore dhe private.

Ofrimi i shërbimeve taksi dhe logjistike, prodhimi i produkteve drunore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e fermave, prodhimi i produkteve nga tabako dhe zhvillimi i software-ve dhe aplikacioneve dixhitale. Kryen operacione komerciale, financiare dhe industriale.

E afte të futet në çdo lloj koncesioni publik dhe privat me autorizim për të gjitha aktivitetet e lartpërmendura, përfshirë shit-blerjen/marrjen me qira të tokave bujqësore dhe industriale, duke mundësuar import-eksport të burimeve nentokesore brenda dhe jashtë vendit, me financime nga jashtë dhe brenda vendit. Furnizim me karburant dhe lubrifikant për mjetet lundruese (detare) si dhe Jet-Oil për mjetet fluturuese ajrore.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar është Kapitali themeltar është 1,000.00 Lekë (një mijë Lekë).

5.2 Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1,000.00 Lekë (një mijë Lekë)

Neni 6 - Kontributet dhe kuotat

6.1 Kontributi i kapitalit themeltar u ofrua si më poshtë:

Zj. Elisa Kumrija, shtetase shqiptare, ofron një kontribut në para të barabartë me 1,000,00 Lekë;

6.2 Sipas kontributeve të lartpërmendura:

Zj. Elisa Kumrija zotëron 1 (një) pjesë të kapitalit themeltar që korrespondon me 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme midis ortakëve siç parashikohet në statutin e kompanisë.

Neni 8 - Administrimi

Administratori i parë i emëruar i kompanisë është Zj. Elisa Kumrija e lindur në Krujë, më 21/04/2000, banues në Rr. Sulejman Delvina, Nd. 37/1, Ap. 6, Njesia Bashkiake nr. 5, Tiranë dhe me dokument identifikues nr. K05421044N, të cilës i janë dhënë të gjitha kompetencat, përveç atyre që ligji ose ky statut i rezervon Asamblesë së Ortakëve.

Neni 9 – Të ndryshme

9.1 Ky Akt Themelues hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Zj. Elisa Kumrija

